

Mbi

Auditimin e Brendshëm

Ushtruar në Njesine Administrative Pult

Njesia e Auditimit Brendshem – Bashkia Shkoder bazuar ne ligjin 114/2015 “Per Auditimin e Brendshem ne sektorin publik”, VKM nr 212 date 30.03.2012 “Per miratimin e kriterëve per ngritjen e Njesive te Auditimit te Brendshem ne sektorin publik”, zhvilloi nje mison auditimi te plote ne Njesine Administrative Pult per periudhen

01.01 .2015 - 31 .12. 2016 nga auditimi rezultoi:

III. PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

Njësia e Auditimit të Brendshëm- Bashkia Shkodër, auditoi ish- komunën Pult, (me reformën e re territoriale) Njësia Administrative Pult. Grupi i auditimit i ngarkuar për kryerjen e angazhimit të auditimit i ka kushtuar vëmendje të veçantë transferimit të veprimtarisë dhe asetëve në Bashkinë Shkodër menaxhimit të pasurisë. Gjatë auditimit janë konstatuar mangësi në funksionimin e kontrollit të brendshëm, kryesisht në vendosjen e objektivave, në pershkrimin e proceseve të punës në kontrollin e aktiviteteve, në monitorimin dhe informimin si dhe në hartimin dhe ndjekjen e regjistrit të riskut. Planifikimi i buxhetit nuk është bërë bazuar rregullorë të vecante të hartimit të buxhetit, nuk është bërë përpilimi i regjistrit të tatimpaguesve. Ka mangësi në dokumentimin, pasqyrimin dhe transferimin aktivitetëve, në mbulimin e Njësise Administrative me shërbime të percaktuara në ligjin e veteqeverisjes vendore.

1.Gjetje : Sipas kërkesave të ligjit nr. 139/2015, “për veteqeverisjen vendore” përkatësisht nën 21-29, 65-66, Ligji nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, përkatësisht nën 8-12, duhej të ishte miratuar rregullorja e brendshme, ku të percaktoheshin qartë objektivat, harta e proceseve, pershkrimi i vendeve të punës, linjat e raportimit e monitorimit, fushta me risk të lartë, plani i veprimit për menxhimin e rriskut, duhej të ishte ngritur grupi i menaxhimit strategjik, të percaktoheshin procedurat e antikorrupsionit.

Keto mangësi ligjore kanë ardhur si rezultat nivelit ulët profesional, dhe mosnjohje të dispozitave ligjore që rregullojnë funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Rekomandim Si rezultat i reformës administrative administrimi i njësise Administrative Pult, ka ndryshuar formën e organizimit dhe drejtimit ku tashmë organizimi dhe funksionimi i kontrollit të brendshëm varet nga Bashkia Qender.

Ne keto kushte rekomandojme :

Hartimin e rregullores së brendëshme për njësi administrative Pult sipas formatit të bashkëlidhur këtij raporti.

2.Gjetje: Ne referencë të neneve 11,23,24 të Ligji t nr.10296 dt.08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar,V.K.B nr. 08 datë 17.04.2015 dhe nr. 01, datë 22.01.2016 “Për miratimin e e taksave e tarifave në Bashkinë Shkodër” Administratori ka përgjegjesine administrimit, monitorimit e raportimit. Per vitin 2015 arketimi i detyrimeve është bërë ne masën 21 % të planifikimit, ndersa në vitin 2016 është ne masen 19 % te planifikimit për taksat e tarifat vendore.

Rekomandim: Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të informimit dhe monitorimit, si dhe kryerjen e dokumentimit, për të bërë të mundur evidentimin në kohë të problematikave me qëllim përmirësimin e eficencës së institucionit.

3.Gjetje : Ka mangesi ne mbajtjen e dosjve te personelit,nuk është bërë vlerësim i punës së punonjësve me status nepunesit civil nuk janë përcaktuar detyrat funksionale të punonjësve, nuk janë përcaktuar dhe ndjekur fushat me rrisht të lartë.

Rekomandim Kryerjen e vlersimit te punes të punonjesve sipas detyrave funksionale.

4.Gjetje. Planifikimi i buxhetit nuk është bërë bazuar rregullore te vecante te hartimit te buxhetit, buxheti nuk është perpiluar bazuar ne nevojat dhe arrijten e objektivave.

Rekomandim: Te kerkohet me shkrim prane Drejtorise Buxhetit per pajisjen me nje rregullore per perpilimin e projekt buxhetit te njesise.

5.Gjetje: Sipas pikes 7 te nenit 4 te ligjit nr. 9632 date 30.01.2006 “Për sistemin e taksave Vendore” i ndryshuar , duhej te ishte perpiluar regjistri i tatimpaguesve vendore duke evidentuar ne menyre analitike detyrimet e tatimpaguesve perfshire taksa dhe tarifa.Njesia administrative Pult per te gjithë periudhen e auditimit nuk ka mbajtur regjister apo evidenca, nuk ka patur bashkepunim ndermjet Drejtorisë Ardhurave Bashkia Shkoder dhe Njesise Administrative per vjeljen me force te detyrimeve te taksapaguesve.

Rekomandime

a. Administrata e njesisë Administrative Pult te fillojë menjehere punen ne bashkepunim me Kryetaret e fshatrave per te ndertuar regjistrin e tatimpaguesve, i ndare sipas aktiviteteteve te biznesit.

b. Administrata e njesisë Administrative Pult te fillojë menjehere punen ne bashkepunim me Kryetaret e fshatrave per te ndertuar regjistrin e tatimpaguesve per familjaret , duke evidentuar siperfaqen e tokes ne perdorim dhe në pronesi,

siperfaqen e kullotave , pyjeve, fidanishte, frutore, sipas ndarjes se paketes fiskale të miratuar.

c.Për siperfaqet e tokave, pyjeve e kullotave qe nuk jane në pronësi të familjeve por që përdoren prej tyre të lidhet kontrate qiraje për përdorimin e tyre.

d.Administrata e Njesisë Administrative Pult , bazuar ne dokumentet qe disponohen te filloje evidentimin e detyrimeve te pa arketuara nga tatimpaguesit per vitet e mepashme dhe duke perdorur masat shtrenguese parashikuara nga ligji per te bere te mundur arketimin e tyre.

6.Gjetje : Sipas nenit 70 te ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” Kryetaret e Fshatrave duhej te ishin zgjedhur jo me vone se tre muaj pas zgjedhjeve te keshillit bashkiak ose duhej te ishin emeruar perkohesisht nga kryetare bashkise.Nga ana e bashkise shkoder jane kryer pagesa per kryepleqt pas kalimit te afatit tre mujor,me nje dëm financiar që i ka sjelle bashkise Shkodër prej 70.000 lek.

7.Gjetje:Ne refence te pikave 140-142 Udhëzimit të Ministrisë së Financave

nr.02 datë 06.02.2012”Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Kërkesa për shpenzim paraqitet nga drejtuesi funksional i aktivitetit të çdo niveli të njësisë /nënprogramit/ programit buxhetor, përgjegjës për realizimin e objektivave të planifikuara në kuadrin e programit respektiv buxhetor.

8.Gjetje: Ne referencë te pikave 5-9 si dhe 23 te udhezimit nr.30 “Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik” i ndryshuar,duhej te ishte përpiluar dhe miratuar rregullore per menaxhimin e aseteteve si dhe duhej bërë një plan veprimi lidhur me mirembajtjen e aktiveve.

9.Gjetje.Referuar pikes 85 te Nr. 30 Datë 27.12.2011 per “PËR MENAXHIMIN E AKTIVEVE NË NJËSITË E SEKTORIT PUBLIK” komisioni i inventarizimit ka pergjegjesine per verifikimin fizik dhe cilesor te gjendjes se aktiveve ,gje qe nuk ka ndodhur per te gjitha asetet e njesise per arsye te terrenit te veshtir.

Rekomandim:Administrata e Njesisë Administrative Pult , duhet te bëjë në terren verifikimin e te gjitha aseteteve qe per arsye te terrenit te veshtir nuk janë verifikuar nga komisioni i ngritur ne zbatim te V.K.M 510, datë 10.6.2015.

10.Gjetje. Nuk është bere planifikimi i punes per kryerjen e sherbimeve publike.

Rekomandim: Planifikimin dhe miratimin e kryerjes sherbimeve publike, si dhe kryerjen e kronometrit per caktimin e normativave shpenzimit karburantit si dhe pasisjen me flete udhetime, ku detyrimisht te percaktohet itinerari , levizjes, vendi i kryerjes sherbimit, volumet e punes kryera dhe ne fund te nenshkruhen nga personi

qe ka kryer sherbimin, personi qe ka kontrolluar sherbimin dhe ne fund miratohet nga administratori.

Njesia Auditimit Brendshem

Bashkia SHKODER